



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË



V E N D I M

Nr. 2 Datë 24.01.2018

“ PËR MIRATIM E LEJES PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR PËR ENERGJI ELEKTRIKE” SUBJEKTIT “HEC TERFOJE” SH.P.K.

Në mbështetje të nenit 7 pika 2 ,të nenit 50, nenit 51, nenit 52, të ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 si dhe të nenit 24, pika f, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, “ Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike , që nuk janë objekt konçesioni”, miratimin paraprak Nr. 3319/3, datë 28.07.2016 dhe shtyrjen e afatit të përcaktuar në miratimin paraprak me shkresën nr.3319/10 Prot. datë 31.10.2017 të MEI, për paisjen me leje të përdorimit të burimit ujqor të subjektit “HEC TERFOJE” SH.P.K, me propozim të A.B.U Drin- Bunë, miratimin në parim të Këshillit Konsultativ dhe oponentës së DPBU në ministrinë përgjegjëse për administrimin e burimeve ujqore, Këshilli i Basenit Ujqor Drin- Bunë,

V e n d o s i :

1-Miratimin e lejes së subjektit “**HEC TERFOJE sh.p.k.**” me administrator Z.Kujtim HASA, për përdorim të burimit ujqor **Përroi i Madh dhe Përroi i Buzëmadhes** për prodhim energjie elektrike në fshatin Fshat, Njësia Adm. Grykë-Çajë, Bashkia Kukës, Qarku Kukës.

Sipas studimit të paraqitur nga subjekti HEC TËRFOJE do të ketë këto të dhëna:

Vepra e marrjes Nr.1:	$X_1 - 44\ 54\ 960;$	$Y_1 - 46\ 43\ 000;$	$Z_1 - +1160\ m;$
Vepra e marrjes Nr.2:	$X_2 - 44\ 55\ 720;$	$Y_2 - 46\ 43\ 300;$	$Z_2 - +1154\ m;$
Koordinatat e godinës së centrali:	$X - 44\ 54\ 440;$	$Y - 46\ 41\ 750;$	$Z - +900\ m;$
Koordinatat e pikës së shkarkimit:	$X - 44\ 54\ 440;$	$Y - 46\ 41\ 750;$	$Z - +900\ m;$
Prurja mesatare vjetore e burimit:	$Q_1\ mes = 0.126\ m^3/sek;$	$Q_2\ mes = 0.605\ m^3/sek;$	
Sasia e ujqit që kërkohet të përdoret nga subjekti:	$Q_1\ llog = 0,15\ m^3/sek;$	$Q_2\ llog = 0,73\ m^3/sek;$	
Prurja ekologjike:	$Q_{1\ ekol} = 0.03\ m^3/sek;$	$Q_{2\ eko\ l} = 0.13\ m^3/sek;$	
Prurja që shkarkohet:	$Q = 0.88\ m^3/sek.$		

2-Leja e përdorimit të burimit ujqor për prodhim energjie elektrike jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zone dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.

3- Ngarkohet A.B.U. Drin-Bunë për zbatimin e ketij vendimi.

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË

SEKRETAR

Raimonda GURI



KRYETAR

Cesk MULLAJA

